Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL
UPRAVA ZA POLEPRIVREDU, SUMARSTVO I RURALNI RAZVOJ
DEPARTMENT OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

11/ Nr._____/2012
Rahovec,06.02.2012

N J O F T I M

Njoftohen vreshtarët-kultivuesit e rrushit të tryezës dhe fare për kultivuesit e domates në serra se, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2012, ka paraparë që të bëjë subvencionimin me pesticide për vreshtat me rrush tryeze dhe për kultivimin e domateve në serra.

Kriteret e aplikimit për kultivuesit e rrushit të tryezës

- Bujku duhet të ketë vreshtë me varietete të rrushit të tryezës
- Certifikatë nga Enti për Vreshtari dhe Verëtari në Rahovec si kultivues i rrushit të tryezës
- Vreshti duhet të jetë së paku në vitin e tretë (3) të prodhimit
- Vreshtari duhet të ketë sipërfaqe mbi 0.40 ha me rrush tryeze
- Vërtetimin e pagesës së tatimit mbi pronën

Kriteret e aplikimit për kultivuesit e domates në serra

- Të jetë kultivues i domateve në serrë
- Të ketë sipërfaqe prej 0.05-0.10 ha të serrës
- Vërtetimi i pagesës së tatimit mbi pronën

Aplikuesit duhet të jenë banorë të komunës së Rahovecit.
Informatat rreth aplikimit mund të merren në Komunën e Rahovecit, përkatësisht në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, nga e hëna deri të premten prej orës 09:oo^{h} - 15:00^{h}
Në datat 13.02.2012 - 28.02.2012

Drejtori I DBPZHR Rahovec
_____
Artan Zenuni ecc i diplomua